



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:072879

Datë: 16.03.2020

Numri i dokumentit: 00902215

PKR. nr. 01/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, me Kryetarin e trupit gjykues Mustaf Tahiri dhe asistentin ligjor Muhedin Rexhepi, në çështjen penale kundër të akuzuarit ..., për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 275 par. 1 lidhur me nenin 281 par. 1 nënpar. 1.7 të KPRK-se, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj - Departamenti i Krimeve të Rënda PP.I. 2/19 datës 30.01.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik me datë 05.03.2020, në praninë e përfaqësuesit të akuzës – Prokurorit të Shtetit Veton Shabani, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij sipas detyrës zyrtare, av.N.B, të njejtën ditë shpalli dhe publikisht komunikoi, ndërsa me datë 05.03.2020 përpiloi me shkrim, këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari ..., nga i ati Z.... dhe nëna M..., e gjinisë M..., i lindur më ..., në Ferizaj, me vendbanim në rr. “R...” – afër furrës “G...”, në Ferizaj, ka të kryer shkollën fillore, me gjendje të dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa martuar, punon në autolarjen “F...”, me numër personal të identifikimit, me numër telefoni

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë me datë 14 nëntor 2018, rreth orës 16.30 në rrugën në Ferizaj, përkatësisht tek parku i qytetit, në kuadër të planit operativ “Stop Drogave në Shkolla”, nga ana e njësisë së DHTN në Ferizaj, me rastin e kontrollit të i pandehuri ... është gjetur një sasi me substancë narkotike marihuanë me peshë rreth 1.40 gram, të cilën substancë i pandehuri e kishte poseduar në mënyrë të paautorizuar në afërsi të shkollës “Gjon Serreqi”.

me të cilën ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 lidhur me nenin 281 par.2 nënpar 1.7 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë dhe neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 41, 42, 45, 46, 73, 74, 75 pika 1.3 dhe 76 të KPRK-ës, dhe nenit 365 të KPPK-ës, e

G J Y K O N

- **DËNIM BURGIMI** në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe
- **DËNIM ME GJOBË NË SHUMË PREJ 200 /dyqind/ euro** të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 dite nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Nëse dënimi i shqiptuar nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 46 par. 3 të KPK-ës do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20 Euro do të vuaj nga një ditë burgimi.
- **Konfiskohet** në mënyrë të përhershme substanca narkotike.
- **Obligohet i pandehuri** që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30/tridhjetë/€, si dhe shumën prej 50/pesëdhjetë/€ për fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të cilat obligohet që ti paguaj në afatin prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Historiku procedural

Prokuroria e Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda me aktakuzën PP.I. 2/19 datës 30.01.2019, ka akuzuar A.L për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shprëndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar 1.7 të KPRK-së dhe të akuzuarit ..., për veprën

penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substncave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 lidhur me nenin281 par.2 nënpar 1.7 të KPRK-së.

Me aktvendimin PKR 13/19 të dt. 10.12.2019, ndaj të pandehurit A.L është veqar procedura penale.

Kryetari i trupit gjykues duke vepruar sipas kësaj akuze ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 05.03.2020, në të cilën i pandehuri ... pas konsultimeve me mbrojtësin e tij të caktuar sipas detyrës zyrtare, është deklaruar fajtor për veprën penale për të cilën e ngarkon akuza.

Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Deklarimi i të pandehurit është vlerësuar se i plotëson kushtet nga neni 248 par. 1 të KPPK-së pasi që i pandehuri ka kuptuar:

- natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë;
- pranimi është bërë vullnetarisht dhe pas konsultimeve te mjaftueshme me mbrojtësin e tij
- deklaratën e të pandehurit të dhënë në procedurë hetimore,
- mbështetet në faktet dhe në provat e çështjes si: vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve i dt. 14.11.2019, raporti i oficerit i dates 14.11.2019, raporti i testit fushor lidhur me ekzaminimin e substancës narkotike e datës 04.12.2018, fotografitë dhe shkresat e lëndës;
- se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, andaj gjyqtari konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Vlerësimi i veprimeve të të akuzuarit

Kryetari i trupit gjykues vlerësoi se në veprimet e të pandehurit formësohen të gjitha tiparet subjektive dhe objektive të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substncave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 lidhur me nenin281 par.2 nënpar 1.7 të KPRK-së, meqë i akuzuari me dashje direkte me datë me datë 14 nëntor 2018, rreth orës 16.30

në rrugën në Ferizaj, përkatësisht tek parku i qytetit, në kuadër të planit operativ “Stop Drogave në Shkollë”, nga ana e njësisë së DHTN në Ferizaj, me rastin e kontrollit të i pandehuri ... është gjetur një sasi me substancë narkotike marihuanë me peshë rreth 1.40 gram, të cilën substancë i pandehuri e kishte poseduar në mënyrë të paautorizuar në afërsi të shkollës “Gjon Serreqi”.

Vlerësimi i dënimit të shqiptuar

Gjykata me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK-së.

Si rrethanë veçanërisht lehtësuese mori, pranimin e fajësisë që në seancën fillestare si dhe rrethanën se është i moshës relativisht të re, pendimin e tij të shprehur dhe premtimin se në të ardhmën nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjashme penale, ndërsa nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese, përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me dënimin e shqiptuar është e pritshme të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPK-ës, se edhe me anë të këtij dënimi do të arrihet qëllimi i dënimit, parandalimi i kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si dhe njëkohësisht do të arrihet edhe qëllimi tjetër që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale. Andaj Gjykata vlerëson se edhe me aplikimin e nenit 75 par. 1 pika 1.3 të KPPK-së, bëri zbutjen e dënimit nën minimumin e paraparë ligjorë, me bindjen se edhe më këto dënime të shqiptuara ndaj të akuzuarit mund të arrihet qëllimi i dënimit.

Konfiskimi dhe shpenzimet procedurale

Konfiskimi i substancës narkotike nga i pandehuri është bërë konform nenit 275 par.3 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në nenin 450 par. 2 pika 6 të KPPK-së, ndërkaq vendimi për pagesën në Fondin për Kompenzimin e Viktimave të Krimit është i bazuar në nenin 39 par. 3 nënpar. 3.2 të LKVK-së.

Nga arsyet e lartpërmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ -DEPARTAMENTI PËR KRIME TË
RËNDA, PKR. nr. 1/20, më 05.03.2020.**

**Asistenti ligjor,
Muhedin Rexhepi**

**Kryetari i trupit gjykues,
Mustaf Tahiri**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 dite, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.